

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga Shkëlqim Berisha - Nga UÇK-ja te UÇD-ja: Beteja e re e Kosovës është Diplomatike
ADRESA	https://www.syri.net/analize/918024/nga-uck-ja-te-ucd-ja-beteja-e-re-e-kosoves-eshte-diplomatike/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHÀ


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 16:42:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 16:22:40 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	96224d1e38d1381bffdcbadaeab5c44df3f298dc7824419e68bf12858ae7120
TEKSTI	7e6f826acc395161a49963597a54770124ee291aedfa75ef0f029cfde9d285f8
PAMJA	8a06cdb142a9055c7761b662835d5fafce211b2ba5ac0cd463d53ea7853bfc196

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b7d8e9d252db41e3a128469af87ac5b17ca789ce59d86caf0f8f855738db21ad
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f7f0073ad38d84bc7b2018e08e1ed9b5f21036120699a0dce35325619714cf4d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b7d8e9d252db41e3a128469af87ac5b17ca789ce59d86caf0f8f855738db21ad>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**ENVER BYTYÇI**Vendimi i Hagës dhe raporti
ynë me të vërtetën!**ENVER ROBELLI**Qëndrimi i Zagrebit dhe
heshija e Tiranës

LAJMI I FUNDIT

SYRI I BOTËS/ Shtrenjtohen kreditë, çfarë po ndodh?



më të lexuarat

Nga UÇK-ja te UÇD-ja: Beteja e re e
Kosovës është Diplomatike'Anëtarësimi i asociuar' Kanada-BE:
Çfarë do të thotë për Otavën dhe EvropënPutini ka një problem me numrin e
ushtarëve dhe vetëm një rrugëdalje të
rrezikshme

Strehim social apo qeverisje imobiliare?

Groenlanda, Danimarka, SHBA - Arrihet
marrëveshja për ishullin Arktik, besimi
tronditetNga UÇK-ja te UÇD-ja: Beteja e re e
Kosovës është Diplomatike

18:22, 20/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Nga Shkëlqim Berisha

Kosova duhet ta kuptojë se një etapë e gjatë politike dhe juridike po i afrohet fundit. Kjo nuk do të thotë se përfunduan përgjegjësitë tona ndaj ish-krerëve të UÇK-së, familjeve të tyre apo viktimave. Procesi juridik vazhdon dhe çdo i dënuar në shkallë të parë ka të drejtën e ankimit, të mbrojtjes dhe të një gjykimi të drejtë.

Megjithatë, Kosova nuk mund të mbetet përgjithmonë peng i së shkuarës.

Dhomat e Specializuara nuk lindën nga një proces i zakonshëm i brendshëm. Ato u paraprinë nga raporti i Dick Marty-t, nga Task-Forca Hetuese e Bashkimit Evropian dhe nga një presion i jashtëzakonshëm ndërkombëtar mbi institucionet e Kosovës. Në vitin 2015, Kuvendi miratoi ndryshimet kushtetuese dhe ligjin përkatës nën paralajmërimin se, nëse nuk vepron vetë, çështja mund të kalonte në Këshillin e Sigurimit të OKB-së.

Sot qarkullojnë pretendime se ndryshimi i qëndrimit amerikan mund të ketë qenë pjesë e një kompromisi më të gjerë me Rusinë. Jason Steinbaum, ish-drejtues i lartë në Kongresin amerikan dhe bashkëpunëtor shumëvjeçar i Eliot Engelit, e ka ngritur këtë tezë në lidhje me negociatat bërthamore me Iranin, por vetë pranon se nuk ekziston asnjë dokument publik që e provon.

Edhe faktet për Rahm Emanuelin duhet të paraqiten drejt. Ai ishte bashkëthemelues dhe bashkëkryetar i Grupit Serb në Kongresin amerikan, përpara se të bëhej shef i kabinetit të Presidentit Obama. Megjithatë, kjo nuk provon se Emanueli drejtoi krijimin e Gjykatës Speciale apo se ekzistoi një marrëveshje e dokumentuar Obama-Rusi.

Nuk kemi nevojë të ndërtojmë teori të pakonfirmuara. Faktet e dokumentuara janë

mjaftueshëm të rënda: Kosova u vendos nën presion, politika amerikane ndryshoi dhe shteti ynë pranoi të krijonte një institucion juridik të jashtëzakonshëm, jashtë territorit të vet dhe pa gjyqtarë kosovarë.

Ajo etapë, megjithatë, nuk mund të jetë më qendra e përhershme e politikës sonë kombëtare. Tani duhet të kalojmë nga UÇK-ja te UÇD-ja: nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës te Ushtria Çlirimtare Diplomatike.

UÇD-ja nuk është ushtri dhe nuk ka armë. Është një organizim kombëtar i dijes, diplomacisë, drejtësisë, lobimit, arkivave, komunikimit strategjik dhe diasporës. Është aftësia për ta mbrojtur të vërtetën e Kosovës jo vetëm në sheshet tona, por në Kongresin amerikan, në parlamentet evropiane, në universitete, në mediat ndërkombëtare dhe në çdo institucion ku formohen opinionet dhe merren vendimet.

Kjo nuk nënkupton harrimin e UÇK-së. Përkundrazi, është vazhdimi i misionit të saj me mjetet që kërkon koha.

Duhet të mbrojmë të drejtën e katër ish-krerëve për ankim dhe proces të drejtë. Duhet t'i respektojmë të gjitha viktimat pa dallim. Në të njëjtën kohë, duhet të dokumentojmë krimet e shtetit serb, të kërkojmë drejtësi për të zhdukurit dhe të mos lejojmë që përgjegjësia e Serbisë të relativizohet.

Njëkohësisht, duhet të dalim nga politika e reagimit emocional. Serbia dhe aleatët e saj kanë investuar për vite me radhë në diplomaci, lobim, dezinformim dhe rishkrim të historisë. Kosova nuk mund t'u përgjigjet vetëm me protesta, slogane dhe deklarata patriotike për konsum të brendshëm.

Na duhet një strategji e re kombëtare:

- diplomaci profesionale dhe e koordinuar;
- ndoshta riktimit të Ministrisë së Diasporës;
- lobim i vazhdueshëm në Uashington dhe në kryeqytetet evropiane;
- angazhim i organizuar i diasporës;
- arkiv ndërkombëtar për krimet e Serbisë;
- mbështetje serioze juridike për procesin e ankimit;
- përballje profesionale me propagandën dhe operacionet hibride;
- investim në studiues, juristë, diplomatë dhe komunikues ndërkombëtarë.

UÇK-ja e fitoi betejën për çlirimin fizik të Kosovës. UÇD-ja duhet ta fitojë betejën për mbrojtjen e saj diplomatike, juridike dhe historike.

Nuk e harrojmë luftën. Nuk i braktisim të dënuarit, familjet apo viktimat. Por as nuk mund të jetojmë përgjithmonë brenda një gjyqi, e as t'ia dorëzojmë të ardhmen një narrative të ndërtuar nga të tjerët.

Koha e pushkës ka përfunduar. Koha e fjalës së argumentuar, dokumentit, ligjit dhe aleancave ka ardhur.

Nga UÇK-ja te UÇD-ja!

Nga çlirimi i territorit, te çlirimi i së vërtetës së Kosovës në botë!

© SYRI.net

Lexo edhe:



Groenlanda, Danimarka, SHBA - Arrihet marrëveshja për ishullin Arktik, besimi tronditet



Strehim social apo qeverisje imobiliare?



Po përgatisim një brez për të dështuar në shkollë

TË NGJASHME



'Anëtarësimi i asociuar' Kanada-BE:
Çfarë do të thotë për Otavën dhe
Evropën



Historia veç me tri shkronja

Shtërngimi i gazit në Evropë: Çfarë
lloj dimri na pret?



A mund t'i mbijetojë tregu i naftës një
luftë të përzetshme me Iranin?

Nga çfarë kanë frikë ekspertët e
'superinteligjencës' së IA?



Tensionet diplomatike Algjeri –
Emiratet e Bashkuara Arabe: Realiteti
i ri i një marrëdhënieje të stuhishme

Vëra e protestave në Pakistan – dhe
bota nuk e vuri re

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Staf i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.